

UDHËZIM
Nr. 3, datë 25.2.2020

**PËR ZHVILLIMIN E PROVIMEVE KOMBËTARE TË ARSIMIT BAZË NË
REPUBLIKËN E SHQIPËRISË, VITI SHKOLLOR 2019–2020, SESIONI I PARË**

Në mbështetje të nenit 102 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të nenit 26 dhe nenit 50, të ligjit nr. 69/2012, “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar,

UDHËZOJ:

1. Provimet kombëtare të arsimit bazë (sesioni i parë), për vitin shkollor 2019–2020, do të zhvillohen si më poshtë:

- a) gjuhë e huaj, më 16 qershor 2020;
- b) gjuhë shqipe, më 19 qershor 2020;
- c) matematikë, më 23 qershor 2020.

2. Procedurat e hartimit dhe të vlerësimit të testeve përcaktohen në rregulloren për zhvillimin e provimeve kombëtare të arsimit bazë.

3. Lista e gjuhëve të huaja, që do të jepen si provim i detyruar, janë: anglisht, italisht, frëngjisht dhe gjermanisht. Testi i gjuhës së huaj hartohet në përputhje me gjuhën e cila në planin mësimor të arsimit të mesëm të ulët trajtohet si gjuhë e huaj e detyruar në nivelin gjuhësor A2.

4. Nxënësit e klasave të 9-ta të shkollave mbështetëse të seksioneve dygjuhëshe italiane, gjermane dhe franceze japin provim gjuhën përkatëse të seksionit në nivelin gjuhësor A2.

5. Provimet kombëtare të arsimit bazë fillojnë në orën 10:00 dhe zgjasin 2 orë e 30 minuta.

6. Nxënësit e pakicave kombëtare zhvillojnë edhe provimin kombëtar të arsimit bazë në gjuhën amtare. Provimi kombëtar i arsimit bazë në lëndën “Gjuhë amtare” do të zhvillohet më 12 qershor 2020.

7. Për hartimin e testit në lëndën “Gjuhë amtare” të pakicës kombëtare greke ndiqet procedura si vijon:

a) testi përgatitet nga një grup pune me 3 (tre) mësues dhe 1 (një) pedagog, të ngritur me urdhër të drejtorit të DRAP-së Fier;

b) mësuesit dhe pedagogët që hartojnë testin, propozohen nga ZVAP-të Gjirokastrë-Libohovë-Dropull, Delvinë-Finiq dhe Sarandë-Konispol;

c) grupi që përgatit testin mblidhet në ZVAP-në Gjirokastrë-Libohovë-Dropull;

ç) testi tërhiqet në ZVAP Gjirokastrë-Libohovë-Dropull;

d) përfaqësuesit e ZVAP-së Delvinë-Finiq dhe ZVAP-së Sarandë-Konispol e tërheqin testin në ZVAP-në Gjirokastrë-Libohovë-Dropull, një ditë para provimit, ndërsa ata të ZVAP-së Gjirokastrë-Libohovë-Dropull e tërheqin testin në ditën e provimit.

8. Për hartimin e testit në lëndën “Gjuhë amtare” të pakicës kombëtare maqedonase ndiqet procedura si vijon:

a) testi përgatitet nga një grup pune me 3 (tre) mësues dhe 1 (një) pedagog, të ngritur me urdhër të drejtorit të DRAP-së Korçë;

b) grupi që përgatit testin mblidhet në DRAP-në Korçë;

c) testi tërhiqet në DRAP Korçë;

ç) përfaqësuesit e ZVAP-së Korçë-Pustec e tërheqin testin në ditën e provimit.

9. Nxënësit me aftësi të kufizuara zhvillojnë provimet kombëtare në përshtatje me veçoritë e tyre.

10. Për institutin e nxënësve që nuk shikojnë “Ramazan Kabashi”, drejtorja e këtij instituti tërheq testin në QSHA, një ditë para zhvillimit të provimit dhe e kthen atë në sistemin e shkrimit *Braille*.

11. Nxënësi mbetës në provimet kombëtare të arsimit bazë ka të drejtën t'i japë ato në sesionin e dytë, sipas procedurave të parashikuara në rregulloren për zhvillimin e provimeve kombëtare të arsimit bazë në Republikën e Shqipërisë.

12. Sektori i kurrikulës, i Zhvillimit Profesional në ZVAP, merr nga Qendrat e Vlerësimit të Testeve dhe ruan të dhënat e çdo nxënësi, të vlerësuesve të testeve dhe të mjediseve ku janë realizuar provimet kombëtare të arsimit bazë. Këto të dhëna dërgohen nëpërmjet DRAP-së, në QSHA dhe DPAP.

13. Ngarkohet për zbatimin e këtij udhëzimi, Sekretari i Përgjithshëm, Drejtoria e Përgjithshme e Politikave dhe Zhvillimit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë, Qendra e Shërbimeve Arsimore, Agjencia për Sigurimin e Cilësisë së Arsimit Parauniversitar, Drejtoria e Përgjithshme e Arsimit Parauniversitar, drejtoritë rajonale të arsimit parauniversitar, zyrat vendore të arsimit parauniversitar dhe institucionet e arsimit parauniversitar.

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I ARSIMIT, SPORTIT
DHE RINISË
Besa Shahini